



# Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Kumtesë për Media

## **RrGK lanson raportin *Buxhetimi për përmirësimin e barazisë gjinore në programet për diasporë***

Me 17 nëntor në Hotel Sirius, prej orës 10:45 – 12:00, Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) do të bëjë prezantimin e rezultateve të përpjekjeve të përbashkëta me Ministrinë e Diasporës dhe Investimeve Strategjike (MDIS), që kanë rezultuar në publikimin e një raporti të ri, të titulluar ***Buxhetimi për përmirësimin e barazisë gjinore në programet për diasporë***. Gjatë këtij lansimi, RrGK do të prezantojë të gjeturat kyçe dhe rekomandimet e arritura nga analiza, si dhe mirëpret diskutim sa i përket të gjeturave.

Në shkurt të vitit 2017, Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike u zotua të zbatojë buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, në pajtueshmëri me obligimet ligjore të caktuara në Ligjin për Barazi Gjinore dhe kërkesat e bëra nga Ministria e Financave në qarkoret e fundit buxhetore.

Që atëherë, zyrtarët e MDIS-së kanë marrë përkrahje nga RrGK sa i përket kryerjes së analizës gjinore të programeve dhe shpenzimeve të mëparshme dhe të tashme. Kryerja e kësaj analize gjinore ishte esenciale për tu siguruar që janë dhënë të dhëna të mjaftueshme në planifikimin buxhetor për vitin 2018 dhe më tej.

Kjo iniciativë u bë e mundur falë mbështetjes së Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA).

Për më shumë informata ju lutem gjeni të bashkangjitur agjendën.